



Republika e Kosovës

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

DREJTORIA KOMUNALE E SHËNDETËSISË

RAPORTI VJETOR I PUNËS 2025



Përmbajtja e raportit

Hyrje dhe pasqyrim i shkurtër i statusit të realizimit të projekteve nga investimet kapitale, mallrat dhe shërbimet, ofrimi i shërbimeve shëndetësore dhe aktivitetet e tjera të DKSH3

Të dhënat mbi buxhetin e shpenzuar nga kategoritë buxhetore për vitin 20258

1. Investimet kapitale.....	10
1.1. Furnizimi me autoambulanca.....	11
1.2. Furnizimi me mamograf.....	12
1.3. Ndërtimi i QKMF-së në ish kampin e KFOR-it	14
1.4. Ndërtimi i QMF-së në lagjen e Trimave (Tusuz).....	15
1.5. Blerja e aparaturave jo mjekësore	17
1.6. Furnizimi me aparatura stomatologjike	17
1.7. Furnizimi me aparatura laboratorike	18
1.8. Blerja e aparaturave mjekësore	18
1.9. Furnizimi me paisje për ngrohje qendrore dhe klimatizim të objekteve të KPSH	19
1.10. Ndërtimi i AMF-së në fshatin Vlashnje.....	20
2. Mallrat dhe shërbimet.....	21
3. Shpenzimet komunale	25
4. Shërbimet shëndetësor.....	26
4.1. Vizitat mjekësore	27
4.2. Vaksinimi	28
4.3. Shërbimi i njësisë diabetike	29
4.4. Shërbimet laboratorike	29
4.5. Shërbimet radiologjike	30
4.6. Shërbimi urgjent.....	31
4.7. Kujdesi shtëpiak	31
4.8. Ndërrimi i natës.....	32
4.9. Shërbimet stomatologjike.....	33
4.10. Vizitat shtëpiake për nëna dhe fëmijë	34
4.11. Shërbimet nga departamenti për shëndetin e gruas.....	35
4.12. Shërbimet nga barnatorja qendrore	36
4.13. Shërbimet e tjera shëndetësore.....	37
5. Subvencionet.....	38
6. Shënimi i Ditëve Botërore të ndryshme	39
7. Aktivitete të tjera të drejtorisë.....	41



Drejtoria e Shëndetësisë gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2025, ka realizuar një numër të konsiderueshëm aktiviteteve dhe punësh të cilat i ka pasur të planifikuara me planin e punës për vitin 2025.

DKSH përveç se ka ofruar shërbimet e rregullta shëndetësore për pacient përmes QKMF-së, në aspektin procedural ka filluar me procedurat e nevojshme për realizimin e projekteve të parapara, duke parashtruar kërkesat tek zyra e Kryetarit për marrjen e vendimeve përkatëse lidhur me projektet si dhe ka përpiluar specifikacionet dhe paramasat për projektet e parapara dhe pas marrjes së vendimeve përkatëse nga ana e Kryetarit, janë hapur procedurat e tenderimit, ku më pas janë nënshkruar kontratat përkatëse për këto projekte dhe janë kryer furnizimet, punët ose shërbimet sipas këtyre kontratave.

Për projektet të cilat kanë qenë në fuqi kontratat nga vitet e kaluara, kanë vazhduar punët, furnizimet apo shërbimet sipas atyre kontratave.

Gjatë kësaj kohe, janë pranuar kërkesat për mbështetje financiare për kategoritë e përcaktuara me rregulloren për ndarjen e subvencioneve si dhe janë realizuar pagesat për këto kategori, sipas kërkesave të parashtruara.

Më poshtë gjeni pasqyrën e projekteve, aktiviteteve, shërbimeve, etj., të cilat janë realizuar gjatë kësaj periudhe në kuadër të DKSH.

PROJEKTET, AKTIVITETET, SHËRBIMET DHE PUNËT E PLANIFIKUARA DHE TË KRYERA NGA DKSH GJATË VITIT 2025

INVESTIMET KAPITALE

Emri i projektit	Statusi i realizimit	Vërejtje
Furnizim me Autoambulanca për QMF	Realizuar	Buxheti i planifikuar për 2025 është marr nga përmbaruesi. Vlera e kontratës për pagesë sipas furnizimit, mbetet si borxh për 2026
Furnizim me Mamograf	Realizuar	Nuk ka
Ndërtimi i QKMF në KFOR	Në proces të realizimit	Kontratë 3 vjeçare
Ndërtimi i QMF në lagjen Tusuz	Në proces të realizimit	Kontratë 3 vjeçare
Blerja e aparaturave jo mjekësore (elektronike, gjenerator)	Realizuar	Nuk ka
Blerja e aparaturave mjekësore	Pezulluar	Buxheti i planifikuar për 2025 është marr nga përmbaruesi
Blerja e aparaturave stomatologjike	Pezulluar	Buxheti i planifikuar për 2025 është marr nga përmbaruesi
Furnizimi me paisje për ngrohje qendrore dhe klimatizim të objekteve të KPSH	Realizuar	Nuk ka

Furnizimi me paisje laboratorike	Realizuar	Nuk ka
Ndërtimi i AMF-së në fshatin Vlashnje	Në proces të realizimit	Buxheti i planifikuar për 2025 është marr nga përmbaruesi

MALLRAT DHE SHËRBIMET

Emri i projektit	Statusi i realizimit	Vërejtje
Furnizim me reagenca laboratorike	Realizuar	Nuk ka
Furnizim me material shpenzues sanitar	Realizuar	Nuk ka
Furnizim me barna për nevojat e QKMF-së	Në realizim e sipër	Kontratë kornizë 12 mujore
Furnizim me filma të RTG	Në proces të realizimit	Kontratë kornizë 12 mujore
Furnizim me material stomatologjik	Në proces të realizimit	Kontratë kornizë 12 mujore
Furnizim me uniforma të punës për personelin shëndetësor	Realizuar	Nuk ka
Furnizimi me libreza sanitare	Dështuar	Nuk ka pasur ofertues
Furnizimi me material higjienik	Realizuar	Nuk ka
Furnizimi me material administrativ	Në proces të realizimit	Kontratë kornizë 12 mujore
Furnizimi me pelet për nevojat e KPSH	Në proces të realizimit	Nuk ka përfunduar me kohë procedura e prokurimit për 2025
Furnizimi me dru për nevojat e objekteve të KPSH	Në proces të realizimit	Nuk ka përfunduar me kohë procedura e prokurimit për 2025
Furnizimi me oksigjen (gaz medicinal)	Në proces të realizimit	Kontratë kornizë 3 vjeçare
Përpunimi statistikor i të dhënave të dala nga realizimi i vizitave sistematike për nxënësit e klasave I, V dhe IX të Komunës së Prizrenit të realizuara më 2023 dhe 2024	Realizuar	Nuk ka
Ofrimi i shërbimeve shëndetësore për mbulimin e kërkesave dhe nevojës për staf shtesë të QKMF-së	Në proces të realizimit	Është nënshkruar kontrata 3 vjeçare në tetor 2025
Trajnimi i profesionistëve shëndetësor të KPSH	Realizuar	Nuk ka
Sigurimi fizik i objekteve të KPSH	Në proces të realizimit	Kontratë kornizë 12 mujore
Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i të gjitha objekteve e shëndetësisë primare	Realizuar	Nuk ka
Furnizimi me shujta ditore për profesionistët shëndetësor që merren me realizimin e vizitave sistematike	Realizuar	Nuk ka

Mirëmbajtja dhe renovimi i objekteve të KPSH	Realizuar	Nuk ka
Mirëmbajtja e paisjeve mjekësore	Në proces të realizimit	Kontratë kornizë 12 mujore
Mirëmbajtja e paisjeve teknike	Në proces të realizimit	Kontratë kornizë 2 vjeçare
Mbushja dhe servisimi i aparateve kundër zjarrit	Realizuar	Nuk ka
Mirëmbajtja e oborreve të objekteve të KPSH	Realizuar	Nuk ka
Mirëmbajtja e paisjeve për laborator	Në proces të realizimit	Kontratë kornizë 12 mujore
Mirëmbajtja e karrigeve stomatologjike	Në proces të realizimit	Kontratë kornizë 12 mujore
Mbikëqyrja e projekteve të DKSH	Realizuar	Nuk ka
Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve zyrtare të Komunës së Prizrenit dhe QKMF	Në proces të realizimit	Kontratë kornizë 3 vjeçare
Furnizimi me tharëse për duar për nevojat e KPSH	Realizuar	Nuk ka
Realizimi i puntorisë lidhur me të gjeturat gjatë vizitave sistematike	Realizuar	Nuk ka
Sigurimi i automjeteve zyrtare të QKMF	Në proces të realizimit	Kontratë kornizë 12 mujore
Lyrja e mbrendshme dhe e jashtme e objekteve të KPSH	Në proces të realizimit	Kontratë kornizë 12 mujore
Furnizimi me inventar për objektet e KPSH	Në proces të realizimit	Kontratë kornizë 12 mujore
Asgjësimi i mbetjeve mjeksore	Në proces të realizimit	Kontratë kornizë 3 vjeçare
Shërbimet e telefonisë mobile	Realizuar	Nuk ka

SHËRBIMET SHËNDETËSORE

Emri i shërbimit	Statusi i realizimit	Vërejtje
Vizitat mjeksore nga mjeku i përgjithshëm dhe mjeku specialist i mjeksisë familjare	Realizuar	Nuk ka
Shërbimi i vaksinimit të rregullt nga kalendari i obliguar për fëmijë dhe vaksinimi për grip sezonal	Realizuar	Nuk ka
Shërbimi diagnostik – analizat laboratorike	Realizuar	Nuk ka
Shërbimi diagnostik – radiologjik	Realizuar	Nuk ka
Shërbimi urgjent	Realizuar	Nuk ka
Shërbimet e kujdesit shtëpiak (paliativ, geriatrik, për personat me aftësi të kufizuar)	Realizuar	Nuk ka

Shërbimet mjekësore nga ndërrimi i tretë (24h)	Realizuar	Nuk ka
Shërbimet stomatologjike	Realizuar	Nuk ka
Shërbimet shëndetësore si EKG, EHO, inhalime, fashime, injeksione, infuzione, etj.	Realizuar	Nuk ka
Vizitat shtëpiake për nëna dhe fëmijë	Realizuar	Nuk ka
Vizita specialistike dhe këshillimore nga mjeku internist, pediatër.	Realizuar	Nuk ka
Shërbimet e kujdesit ndaj gruas nga departamenti për kujdes ndaj gruas siç janë: klasat për nëna, këshillimore, papa test, etj.	Realizuar	Nuk ka
Shërbimet nga barnatorja qendrore e QKMF-së	Realizuar	Nuk ka
Shërbimet e transportit për të sëmurët me dializë	Realizuar	Nuk ka
Këshillime, udhëzime, etj.	Realizuar	Nuk ka

SHËNIMI I DITËVE BOTËRORE

Emri i Ditës Botërore	Statusi i Realizimit	Vërejtje
Dita Botërore e Kancerit	Realizuar	Nuk ka
Dita Botërore e TBC	Realizuar	Nuk ka
Java Botërore e Imunizimit	Realizuar	Nuk ka
Dita Botërore e Hipertensionit	Realizuar	Nuk ka
Dita Botërore e Gjdhënjes	Realizuar	Nuk ka
Muaji i Kancerit të Gjirit	Realizuar	Nuk ka
Dita Botërore e Diabetit	Realizuar	Nuk ka
Dita Botërore kundër HIV/AIDS	Realizuar	Nuk ka

AKTIVITETE TË TJERA


Emri i aktivitetit	Statusi i realizimit	Vërejtje
Vizita njoftuese nëpër institucionet e KPSH	Realizuar	Nuk ka
Realizimi i vizitave sistematike në shkollat për nxënësit e klasave 1, 5 dhe 9	Realizuar	Nuk ka
Pranimi i një donacioni me paisje mjekësore nga Ambasada e Bullgarisë	Realizuar	Nuk ka
Aktivitetet vetëdijësuese me rastin e shënimit të Ditëve Botërore	Realizuar	Nuk ka

Nënshkrimi i memorandumit të bashkëpunimit ndërmjet DKSH dhe DPMS për mbikëqyrje të objekteve të DKSH	Realizuar	Nuk ka
Organizimi i puntorisë lidhur me të gjeturat gjatë vizitave sistematike të nxënësve nëpër shkollat e Komunës së Prizrenit	Realizuar	Nuk ka
Pjesëmarrja në takime, tryeza dhe aktivitete të tjera nga zyrtar të DKSH	Realizuar	Nuk ka
SUBVENCIONET		
Emri i projektit	Statusi i realizimit	Vërejtje
Mbështetja financiare për kategoritë e përcaktuara për mbështetje financiare nga DKSH sipas rregullores për subvencione të Komunës së Prizrenit.	Realizuar	Janë mbështetur financiarisht kërkesat e pranura nga muaji shkurt deri në muajin korrik 2025. Kërkesat e parashtruara nga muaji gusht deri në muajin dhjetor 2025 janë bartur për realizim në vitin 2026 si shkak i mungesës së mjeteve buxhetore.

Në vijim do të shpalosim raportin e detajuar për secilin projekt, shërbim dhe aktivitet të realizuar nga DKSH.

DKSH, për vitin fiskal 2025 ka pasur në dispozicion buxhetin prej **9,158,118.79** eurosh, i cili ka qenë i dedikuar për kategoritë e pagave dhe mëditjeve, investimeve kapitale, mallrave dhe shërbimeve dhe shpenzimeve komunale. Buxheti i shpenzuar për kategorinë e subvencioneve për kërkesat drejtuar DKSH për mbështetje financiare, është realizuar nga mjetet të cilat kanë qenë nën menaxhimin e zyrës së Kryetarit të Komunës.


Nga shuma totale e buxhetit të planifikuar, DKSH ka shpenzuar **9,120,796.32** euro ose **99,59 %** të buxhetit në të gjitha kategoritë. Kjo vlerë është shpenzuar përmes realizimit të pagesave për projektet e planifikuara të DKSH-së, por një pjesë e kësaj vlere është marrë edhe përmes procedurave përmbarimore për obligimet e ndryshme të Komunës së Prizrenit të cilat kryesisht nuk kanë pasur të bëjnë me DKSH-në. Në grafikonin e mëposhtëm mund të gjeni pasqyrën e saktë të buxhetit të planifikuar, shpenzuar dhe mbetur gjatë kësaj periudhë



Për secilën kategori, ky ka qenë parashikimi i mjeteve për vitin 2025:



Bazuar në kategoritë buxhetore, më poshtë gjeni grafikunin i cili pasqyron shpenzimin dhe mbetjet e mjeteve për këtë periudhë sipas këtyre kategorive.



Në vijim gjeni raportet detale për secilën kategori, përkatësisht projekt.


1. Investimet kapitale


Nga kategoria e investimeve kapitale, DKSH ka pasur të planifikuara realizimin e projekteve si më poshtë për vitin 2025:

1. Furnizim me autoambulanca për QMF;
2. Furnizim me aparat të mamografisë;
3. Ndërtimi i QKMF-së në KFOR;
4. Ndërtimi i QMF-së në lagjen Tusuz;
5. Blerja e aparaturave jo mjekësore (elektronike, kamera, gjenerator, teknika e bardhë, etj.);
6. Furnizim me aparatura stomatologjike;
7. Furnizimi me aparatura laboratorike;
8. Furnizimi me aparatura mjekësore;
9. Furnizimi me paisje për ngrohje qendrore dhe klimatizim të objekteve të KPSH;
10. Ndërtimi i AMF-së në fshatin Vlashnje.

Buxheti i planifikuar për realizimin e këtyre projekteve, ka kapur vlerën e **1,700,000.00** eurosh. Nga ky buxhet janë shpenzuar **1,698,081.40** apo rreth **99.88 %** të këtyre mjeteve. Kjo vlerë është shpenzuar përmes realizimit të pagesave për projektet e planifikuara të DKSH-së, por një pjesë e kësaj vlere është marrë edhe përmes procedurave përmbartimore për obligimet e ndryshme të Komunës së Prizrenit të cilat kryesisht nuk kanë pasur të bëjnë me DKSH-në. Në grafikonin e mëposhtëm mund të gjeni pasqyrën e saktë të buxhetit të planifikuar, shpenzuar dhe mbetur gjatë kësaj periudhe.

Më poshtë gjeni të bashkangjitur në mënyrë grafike raportin për planifikimin, shpenzimin dhe mbetjen buxhetore për këtë kategori, si dhe ndarjen e buxhetit nga kjo kategori për secilin projekt.





Informatat e detajuara lidhur me secilin projekt nga kjo kategori janë të shpalosura në vijim.


1.1. Furnizimi me autoambulanca

Për këtë projekt DKSH ka planifikuar shumën prej **150,000.00** eurosh për vitin 2025.

Pas nënshkrimit të kontratës për furnizim me autoambulanca në vlerë prej **139,450.00** është bërë furnizimi me dy automjete të tilla të cilat do të ndihmojnë në kryerjen e shërbimeve urgjente për qytetarët e Komunës së Prizrenit.

Mirëpo përgjatë periudhës sa ky projekt ka qenë në realizim e sipër, mjetet e parapara në vlerë prej **150,000.00** për këtë projekt janë marrë nga ana e përbaruesit për përmbushjen e obligimeve të dala nga vendimet gjyqësore të Komunës së Prizrenit, obligime të cilat nuk kanë pasur të bëjnë me këtë projekt. Si rrjedhojë obligimet kontraktuale nga ky projekt në vlerë prej **139,450.00** janë bartur për realizim për vitin 2026.

Më poshtë gjeni një grafikun lidhur me planifikimin, shpenzimin dhe mbetjen e buxhetit për këtë projekt si dhe disa fotografi me rastin e pranimit të tyre.



1.2. Furnizimi me mamograf


Për furnizimin me aparat të ri të mamografisë për QKMF, në vitin 2025 janë planifikuar gjithsej **150,000.00** euro.

Kontrata e nënshkruar për blerje të këtij aparati, ka kapur vlerën e **149,595.00** euro.

Me anë të këtij aparati të ri, synohet që të ofrohen shërbime sa më të mira për pacient, sidomos në aspektin e detektimit të hershëm dhe parandalimin e sëmundjes së kancerit të gjirit tek pacientët.

Ky aparat është sjellë fizikisht në hapësirat e QKMF-së dhe pritët të montohet dhe funksionalizohet tek objekti i ri i cili është në proces të ndërtimit.

Më poshtë gjeni një grafikon lidhur me planifikimin, shpenzimin dhe mbetjen e buxhetit për këtë projekt si dhe disa fotografi me rastin e pranimit të këtij aparati.



1.3. Ndërtimi i QKMF-së në ish kampin e KFOR-it

Ky projekt ka filluar të implementohet që nga viti 2022.

Duke pasur parasysh që është projekt shumë vjeçar, për këtë vit DKSH ka planifikuar një buxhet prej **430,000.00** eurosh për realizimin e disa fazave të këtij projekti, pasi që komplet realizimi i projektit kap shifrën e rreth **2,536,218.50** eurosh, me kontratën fillestare me vlerë **2,323,000.00** euro si dhe punët shtesë të miratuara në vlerë prej **99,646.50** eurosh me aneks kontratën e parë dhe **113,572.00** eurosh me aneks kontratën e dytë.

Buxheti i planifikuar për 2025 në vlerë prej **430,000.00** eurosh është shpenzuar në tërësi sipas punëve të kryera në objektin që është në përfundim e sipër. Për shkak të mungesës së mjeteve për realizim të pagesave për punët që janë kryer, për këtë projekt janë marrë përmes procedurave përmbartimore **200,000.00** euro shtesë, jashtë planifikimit të paraparë.

Më poshtë gjeni një grafikon lidhur me planifikimin, shpenzimin dhe mbetjen e buxhetit për këtë projekt si dhe disa fotografi që pasqyrojnë fazën e ndërtimit të këtij objekti.





Objekti i QKMF tek ish kampi i KFOR.


1.4. Ndërtimi i QMF-së në Lagjen e Trimave (Tusuz)

DKSH gjatë vitit 2024 ka planifikuar që të fillojë punimet për ndërtimin e një QMF-je të re në Lagjen e Trimave. Ky projekt është planifikuar që të jetë projekt shumë vjeçar për të cilin janë planifikuar gjithsej **770,262.65** euro për realizim të tij.

Për vitin 2025, për këtë projekt është planifikuar që të shpenzohet vlera prej **430,000.00** eurosh, të cilat janë shpenzuar në tërësi.

Mirëpo përgjatë periudhës sa ky projekt ka qenë në realizim e sipër, mjetet e parapara në vlerë prej **199,298.00** nga totali prej **430,000.00** të parapara për këtë projekt janë marrë nga ana e përmbaruesit për përmbushjen e obligimeve të dala nga vendimet gjyqësore të Komunës së Prizrenit, obligime të cilat nuk kanë pasur të bëjnë me këtë projekt. Për punimet e realizuara gjatë vitit 2025 sipas kontratës nga totali prej **430,000.00** eurove të planifikuara janë shpenzuar **230,701.25**.

Më poshtë gjeni në mënyrë grafike shpenzimin e buxhetit nga ky kod dhe disa fotografi lidhur me punimet e kryera nga ky projekt.




1.5. Blerja e aparaturave jo mjekësore

Për blerjen e aparaturave jo mjekësore për vitin 2025, kanë qenë të planifikuara **20,000.00** euro.

Nga ky kod, është nënshkruar kontrata për furnizim me pajisje elektronike në vlerë prej **18,496.40** euro, vlerë e cila është shpenzuar në tërësi.

Grafikisht të dhënat mbi shpenzimet nga ky kod i gjeni më poshtë:



1.6. Furnizimi me aparatura stomatologjike

Për vitin 2025 për këtë projekt kanë qenë të planifikuara **30,000.00** euro.


Për shkak të marrjes së të gjitha mjeteve nga ana e përmbauesit nga ky kod, projekti për blerjen e aparaturave stomatologjike për këtë vit ka dështuar.

1.7. Furnizimi me aparatura laboratorike

Për këtë projekt kanë qenë të planifikuara 50,000.00 për vitin 2025.

Pas nënshkrimit të kontratës në vlerë prej 49,990.00 eurosh është bërë furnizimi me paisjet si: analizator biokimik, analizator imunologjik POC, analizator hematologjik dhe centrifuga laboratorike.

Më poshtë gjeni një grafikon lidhur me planifikimin, shpenzimin dhe mbetjen e buxhetit për këtë projekt.



1.8. Furnizimi me aparatura mjekësore

Për vitin 2025 për këtë projekt kanë qenë të planifikuara **100,000.00** euro.


Edhe te ky projekt për shkak të marrjes së të gjitha mjeteve nga ana e përmbaruesit, realizimi i blerjes së aparaturave mjekësore për këtë vit ka dështuar.

1.9. Furnizimi me paisje për ngrohje qendrore dhe klimatizim të objekteve të KPSH

Për realizimin e këtij projekti, për vitin 2025 kanë qenë të planifikuara **50,000.00** euro.

Për shkak të borxhit të mbetur nga kontrata e vitit 2024 nga ky kod janë shpenzuar 20,000.00 euro për pagesë të një pjese të këtij borxhi. Ndërsa pjesa tjetër në vlerën 30,000.00 është marrë nga përmbaruesi për përmbushjen e obligimeve të dala nga vendimet gjyqësore të Komunës së Prizrenit, obligime të cilat nuk kanë pasur të bëjnë me këtë projekt.


Grafikisht, gjeni më poshtë të paraqitur shpenzimin buxhetor për këtë projekt.



1.10. Ndërtimi i AMF-së në fshatin Vlashnje

Edhe për këtë projekt, mjetet e parapara në vlerë prej **50,000.00** eurosh janë marrë nga ana e përmbaruesit për përmbushjen e obligimeve të dala nga vendimet gjyqësore të Komunës së Prizrenit, obligime të cilat nuk kanë pasur të bëjnë me këtë projekt. Si rrjedhojë realizimi i këtij projekti për vitin 2025 nuk ka qenë i mundur, prandaj ky projekt është bartur për realizim për vitin 2026.

Këtë vit është kontraktuar vetëm projektimi i projektit kryesor i kësaj AMF-je. Grafikisht të dhënat mbi shpenzimet nga ky kod i gjeni më poshtë:




2. Mallrat dhe shërbimet

Buxheti i planifikuar për projektet të cilat hyjnë në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve për vitin 2025, ka qenë **1,988,739.84** euro.

Nga ky buxhet, vlera e shpenzuar për këtë vit kap vlerën e **1,958,215.94** eurosh, përkatësisht rreth **98,46 %** të buxhetit të planifikuar. Kjo vlerë është shpenzuar përmes realizimit të pagesave për projektet e planifikuara të DKSH-së, por një pjesë e kësaj vlere është marrë edhe përmes procedurave përmbartimore për obligimet e ndryshme të Komunës së Prizrenit të cilat kryesisht nuk kanë pasur të bëjnë me DKSH-në.

Buxheti i planifikuar, i shpenzuar dhe i mbetur do të dukeshin si më poshtë në formë grafike:




Shumica e projekteve nga kjo kategori, janë projekte të cilat kanë të bëjnë me furnizime të ndryshme, me anë të së cilave mundësohet ofrimi sa më i mirë i shërbimeve shëndetësore dhe të cilat ndikojnë në mbarëvajtjen e punëve të përditshme të institucioneve shëndetësore, përfshirë këtu furnizimet me reagenca laboratorike, me filma rtg, me gaz medicinal, me dru, me pelet, me barna, me material shpenzues sanitar, material higjienik, material administrativ, etj.

Mirëpo ka edhe projekte të shërbimeve dhe punëve siç janë mirëmbajtja dhe renovimi i objekteve të KPSH, mirëmbajtja e oborreve dhe kopshteve në institucionet e KPSH, sigurimi fizik i objekteve të KPSH, mirëmbajtja e paisjeve teknike, mirëmbajtja e aparaturave mjekësore, trajnimi i profesionistëve shëndetësor, etj.

Mirëpo për gjatë periudhës sa ky projekt ka qenë në realizim e sipër, mjetet e parapara në vlerë prej **869,852.09** euro nga totali prej **1,988,739.84** euro të parapara për këtë kategori buxhetore janë marrë nga ana e përmbartuesit për përmbushjen e obligimeve të dala nga vendimet gjyqësore të Komunës së Prizrenit,

obligime të cilat kryesisht nuk kanë pasur të bëjnë me projektet e DKSH-së. Për furnizimet dhe shërbimet e realizuara gjatë vitit 2025 sipas kontratave të lidhura me OE për plotësim të nevojave të KPSH, nga totali prej **1,988,739.84** eurove të planifikuara janë shpenzuar **1,110,178.57** euro.

Ky buxhet është shpenzuar në vlerat e paraqitura për disa nga projektet e ndryshme sipas grafikonit të mëposhtëm:



Nga këto projekte të mësipërme, vlen të veçohet projekti i mirëmbajtjes dhe renovimit të objekteve shëndetësore dhe i lërjes së objekteve shëndetësore ku kemi realizuar shumë punë nëpër njësitë shëndetësore, duke funksionalizuar objektin e AMF në fshatin Lubizhdë të Hasit, kemi përmirësuar infrastrukturën e AMF në Skorobisht, si dhe janë lër hapësirat e brendshme dhe të jashtme të shumë objekteve shëndetësore. Më poshtë do të bashkangjesim disa fotografi lidhur me realizimin e këtyre punimeve.

Renovimi i AMF-së në Lubizhdë të Hasit





Renovimi i AMF-së në Skorobisht




Renovimi i pllakave në QMF Zhur



3. Shpenzimet komunale

Për mbulimin e shpenzimeve komunale, përfshirë këtu furnizimin me ujë, furnizimin me rrymë, mbledhjen e mbeturinave, etj, nëpër të gjitha institucionet e shëndetësisë primare, përfshirë QKMF-në, QMF-të, AMF-të në Komunën e Prizrenit, DKSH për vitin 2025 ka planifikuar për shpenzim shumë prej **206,400.00** eurosh. Nga ky buxhet, gjatë periudhës 12 mujore është shpenzuar gjithsej **201,520.03** euro, ose shprehur në përqindje rreth **97.63%**.

Buxheti i shpenzuar dhe i mbetur, do të dukeshin si më poshtë:



4. Shërbimet shëndetësore

Komuna e Prizrenit, shërbimet shëndetësore për qytetarët e saj i ofron përmes njësive shëndetësore siç janë QKMF, QMF-të dhe AMF-të.

Gjithsej në tërë territorin e Komunës së Prizrenit janë **44** njësi shëndetësore që ofrojnë shërbime shëndetësore. Prej tyre është **1** QKMF në të cilën ofrohen të gjitha shërbimet shëndetësore të parapara me udhëzimin administrativ për kujdesin parësor shëndetësor, përfshirë këtu edhe shërbimet diagnostike laboratorike dhe radiologjike; **1** qendër e shërbimit urgjent ku ofrohen shërbimet urgjente për qytetarët e komunës; **15** QMF në të cilat ofrohen shërbimet e rregullta shëndetësore, ndërsa në **4** prej tyre edhe shërbimet laboratorike; dhe **27** AMF, në **24** prej të cilave ofrohen shërbimet shëndetësore dhe plotësojnë kriteret përkatëse për ofrim të këtyre shërbimeve.

Këto shërbime ofrohen nga stafi profesional shëndetësor. Numri i të punësuarve në QKMF edhe pse varion nga muaji në muaj si shkak i lëvizjeve të ndryshme, sipas të dhënave të muajit dhjetor të vitit 2025, ky numër është **448** të punësuar. Nga ky numër, **111** prej tyre janë mjek, prej të cilëve **57** mjek specialist të mjeksisë familjare dhe **54** mjek të përgjithshëm, **247** infermier, **27** stomatolog, **21** asistent të stomatologjisë dhe **60** staf tjetër, përfshirë mjek specialist të pediatrikës, radiologjisë, biokimisë, internistikës, teknik laborant, staf administrativ dhe mbështetës, punëtor higjienik, etj.

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2025, DKSH përmes njësive shëndetësore dhe stafit të tyre profesional ka ofruar një numër të madh të shërbimeve shëndetësore. Ky numër arrin shifrën e rreth **922,250** shërbime shëndetësore, duke përfshirë por mos kufizuar në shërbimet si: vizita specialistike mjekësore, vaksinim, analiza laboratorike, rtg, shërbime urgjente, shërbime shtëpiake (geriatrike, shërbime të kujdesit paliativ, etj.), shërbime stomatologjike, vizita shtëpiake për nëna dhe fëmijë, EKG, fashime, inhalime, injeksione, infuzione, këshillime, udhëzime, etj.

Numri i shërbimeve shëndetësore sipas muajve ndahet si më poshtë:



Më poshtë do të shpalosim numrin e disa prej shërbimeve të ofruara, duke dhënë statistika mujore për numrin e realizuar të këtyre shërbimeve nëpër institucionet shëndetësore.


4.1. Vizitat mjekësore

Në total janë realizuar gjithsej **391,472** vizita mjekësore, prej të cilave **143,837** vizita nga mjeku i përgjithshëm dhe **247,635** vizita specialistike nga mjeku specialist i mjekësisë familjare. Të ndara në muaj, numri i këtyre vizitave është si vijon:



4.2. Vaksinimi


Sipas planifikimit të bërë, për vitin 2025 janë planifikuar për imunizim **12,477** fëmijë nga kalendari i obligueshëm i imunizimit, prej të cilëve janë imunizuar **11,540** fëmijë apo **92.49%** e tyre. Gjatë kësaj periudhe janë administruar edhe **4,491** doza të vaksinës kundër gripit sezonal, ndërsa vakcina kundër **Covid-19** janë dhënë **4** doza të vaksinës. Më poshtë gjeni grafikisht përqindjen e imunizimit nga kalendari I obligueshëm për fëmijë si dhe aplikimin e vaksinave të ndryshme sipas muajve :



4.3. Shërbimi i Njesisë Diabetike

Njësia diabetike gjatë kësaj periudhe ka ofruar gjithsej **6,569** shërbime shëndetësore për pacient, duke përfshirë vizita për pacient, egzaminime të ECHO abdomenit, matja e glikemisë, vizita për trajtimin e shpëtës diabetike, etj. Si shkak i daljes në pension të mjekut specialist të kësaj fushe, ky shërbim është ofruar vetëm 4 muajt e parë të vitit 2025.


Në grafikonin e mëposhtëm gjeni ofrimin e këtyre shërbimeve në baza mujore:



4.4. Shërbimet laboratorike


Shërbime diagnostike për analiza laboratorike, hematologjike, biokimike dhe në përgjithësi analiza të tjera në laboratorin e QKMF, QMF 1, QMF- Reqanë, QMF Gjonaj dhe QMF Zhur janë kryer gjithsej **48,893** shërbime.

Grafikoni i mëposhtëm paraqet realizimin e këtyre analizave sipas muajve.




4.5. Shërbimet radiologjike

Shërbime diagnostike radiologjike përfshirë ECHO të gjirit, mamografi, ortopan, RTG, etj., gjatë kësaj periudhe janë realizuar gjithsej **5,217** shërbime.




Në kuadër të shërbimeve radiologjike të ofruara, vlen të përmendet numri mamografive të realizuara gjatë kësaj periudhe. Në total janë realizuar gjithsej **256** mamografi nga stafi i QKMF. Si shkak i defektit të aparatit të mamografisë, në disa nga muajt e këtij viti nuk është realizuar asnjë mamografi, deri në blerjen e aparatit të ri. Numrin e mamografive të realizuara të ndara në muaj e gjeni më poshtë:




4.6. Shërbimi Urgjent

Shërbime urgjente të ofruara nga Shërbimi Urgjent në kuadër të QKMF-së, përfshirë vizitat në teren, vizitat ambulantore, transportet për spital, vizitat gjatë aksidenteve nga ekipet e urgjencës, vdekjet e konfirmuara nga ekipet e urgjencës, infuzionet, etj., janë realizuar gjithsej **24,106** shërbime gjatë kësaj periudhe.



4.7. Kujdesi shtëpiak

Gjatë kësaj periudhe kohore, janë realizuar gjithsej **8,888** shërbime shëndetësore nga kujdesi shtëpiak, përfshirë këtu shërbimet shëndetësore për të sëmurët në fazën terminale të sëmundjes (kujdesi paliativ), për personat me aftësi të kufizuar dhe që nuk kanë mundësi çasjeje në objektet shëndetësore, shërbime për të moshuarit (kujdesi geriatrik) të cilëve u janë ofruar shërbimet shëndetësore si vizitat mjekësore, dhënjën e injeksioneve, infuzioneve, barërave, vendosjen e kateterit, fashim, etj. Grafikoni i mëposhtëm pasqyron numrin e shërbimeve të ofruara në shtëpi sipas muajve përkatës.



4.8. Ndërrimi i natës


Në kuadër të ndërrimit të natës ose ndryshe ndërrimit të tretë me anë të të cilit kompletëhet shërbimi 24 orë për qytetarët, janë ofruar **73,546** shërbime shëndetësore për pacient përfshirë këtu vizitat mjekësore, dhënjën e injeksioneve, infuzioneve, fashim, etj.. Për secilin muaj veç e veç, keni të paraqitur më poshtë numrin e shërbimeve të ofruara.



4.9. Shërbimet stomatologjike

Në kuadër të ktyre shërbimeve ku përfshihen vizitat, mbushjet e dhëmbit, nxjerrjet, inqizimet, etj., janë realizuar gjithsej **56,337** shërbime në kuadër të këtij dikasteri të Kujdesit Parësor Shëndetësor në Komunën e Prizrenit.


Grafika e mëposhtme jep numrin e shërbimeve mujore në këtë department.



4.10. Vizitat shtëpiake për nëna dhe fëmijë (0-3 vjeç)


Gjatë kësaj periudhe, DKSH përmes ekipeve të QKMF ka ofruar një numër të madh të vizitave për këtë kategori. Në total janë ofruar **3,018** vizita të tilla, prej të cilave **478** vizita për lehona, **2,153** vizita për fëmijë dhe **473** vizita për shtatzëna.

Në kuadër të këtij numri, hyjnë edhe rreth **370** vizita të ofruara për komunitetin RAE për këto kategori, prej të cilave **73** vizita për lehona, **84** vizita për shtatzëna dhe **221** fëmijë të këtij komuniteti. Më poshtë do të pasqyrojmë këto vizita të ofruara sipas muajve:



4.11. Shërbime nga departamenti për shëndetin e gruas

Nga ky departament, për këtë vit janë realizuar gjithsej **2,701** shërbime, përfshirë këtu **558** vizita gjinekologjike (deri në muajin nëntor pasi që mjeku ka dalë në pension), **462** strisho vaginale, **1,000** papa teste, **207** ECHO gjinekologjike (deri në muajin nëntor pasi që mjeku ka dalë në pension), etj. Të ndara sipas muajve, gjeni këto shërbime të bashkangjitura më poshtë:



4.12. Shërbimet nga Barnatorja qendrore

Gjithsej gjatë këtij viti, kanë marrë shërbime në barnatore **38,013** pacient, prej të cilëve **13,601** janë furnizuar me insulina ndërsa **24,412** me barëra të tjerë. Gjithashtu nga barnatorja janë furnizuar edhe të gjitha njësitë shëndetësore të KPSH në Prizren për përmbushjen e nevojave të tyre për ofrimin e rregullt të shërbimeve shëndetësore për pacient.

Përgjatë muajve, furnizimet janë bërë si më poshtë:




Bazuar në planifikimin e bërë dhe në përqindjen e furnizimit nga ana e Ministrisë gjatë këtij viti, më poshtë gjeni të pasqyruar raportin për furnizim me barna, material sanitar dhe insulina:



4.13. Shërbime të tjera shëndetësore

Në grafikonin e mëposhtëm do të paraqesim edhe numrin total të disa prej shërbimeve të tjera të cilat janë realizuar gjatë kësaj periudhe.



5. Subvencionet

Duke filluar nga muaji shkurt e deri më 31 dhjetor 2025, është bërë pranimi i dokumentacioneve për mbështetje financiare për kategoritë e përcaktuara në rregulloren për ndarjen e subvencioneve. Fluksi i personave që kanë aplikuar për mbështetje ka qenë mjaft i madh. Gjatë kësaj periudhe, janë parashtruar **1,232** kërkesa për mbështetje financiare nga këto kategori. Prej tyre, janë aprovuar **1,151** kërkesa janë refuzuar **23** prej tyre si shkak i mos përmbushjes së kriterëve të parapara me rregullore, ndërsa për **58** kërkesa të muajit dhjetor nuk është marrë akoma vendim për aprovim ose refuzim të tyre.


Prej kërkesave të aprovuara të cilat janë parashtruar nga muaji shkurt e deri në fund të muajit korrik 2025 që përbënë numrin e **955** kërkesave është realizuar pagesa. **249** kërkesa të tjera të parashtruara gjatë muajit gusht, shtator, tetor, nëntor dhe dhjetor për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore, të njëjtat kanë mbetur që të realizohen gjatë vitit 2026.

Për **955** kërkesat për të cilat është realizuar pagesa, janë shpenzuar gjithsej **382,150.00** euro.

Gjithashtu, është realizuar pagesa për **179** persona kërkesat e të cilëve janë pranuar më 2024, mirëpo si shkak i mungesës së mjeteve financiare më 2024 janë përcjellur për realizim më 2025. Shuma që është ndarë për këta persona kap vlerën e **71,600.00** eurosh.

Në total, shuma me të cilën janë mbështetur këto raste, duke përfshirë edhe kërkesat e parashtruara gjatë muajve shtator-nëntor 2024, kap vlerën e **453,750.00** eurove.

Nga totali i përfituesve për të cilët janë realizuar pagesat gjatë 2025, përfshirë këtu edhe kërkesat e bartura nga 2024, kanë përfituar komunitetet si më poshtë:



6. Shënimi i Ditëve Botërore

DKSH me aktivitete të ndryshme, ka bërë shënimin e ditëve botërore të përcaktuara me kalendarin botëror të shënimit të këtyre ditëve. Më poshtë gjeni të radhitura Ditët Botërore për të cilat DKSH ka realizuar aktivitetet e saj.

Emri i ditës botërore	Koha e shënimit të saj	Aktiviteti
Dita Botërore e Kancerit	02 shkurt 2025	Ligjeratë e organizuar në QKMF për profesionistët shëndetësor
Dita Botërore e TBC	25 mars 2025	Ligjeratë e organizuar në QKMF për profesionistët shëndetësor
Java Botërore e Imunizimit	24-26 prill 2025	1. Aktivitete vetëdijësuese nëpër QMF 2. Ligjeratë e organizuar në QKMF për profesionistët shëndetësor
Dita Botërore e Hipertensionit	17 maj 2025	Ligjeratë e organizuar në QKMF për profesionistët shëndetësor
Java Botërore e Gjdhënjes	01-07 gusht 2025	1. Ligjeratë e organizuar në QKMF për profesionistët shëndetësor 2. Ofrimi i këshillave shëndetësore për pacient
Dita Botërore e Zemrës	29 shtator 2025	Ligjeratë e organizuar në QKMF për profesionistët shëndetësor
Muaji i Kancerit të Gjirit	01-30 tetor 2025	Gjatë këtij muaji, janë realizuar vizita rutinore për gra, ku janë përfshirë vizita specialistike, eho dhe mamografi nga mjeku specialist. Gjithashtu janë realizuar aktivitete vetëdijësuese, ligjerata dhe takime me grupe të ndryshme nga ana e profesionistëve shëndetësor. Si dhe është realizuar marsh vetëdijësues nga QKMF deri te Lidhja e Prizrenit.

Dita Botërore e Diabetit	14 nëntor 2025	Ligjeratë e organizuar në QKMF për profesionistët shëndetësor
Dita Botërore e HIV/AIDS	1 dhjetor 2025	Ligjeratë e organizuar në QKMF për profesionistët shëndetësor

Më poshtë do të bashkangjesim edhe disa fotografi nga aktivitetet e ndryshme të realizuara në kuadër të shënimit të këtyre ditëve.



7. Aktivitete të tjera

Përgjatë kësaj periudhe, DKSH ka realizuar edhe një numër të konsiderueshëm aktivitete të ndryshme. Më poshtë do të shpalosim disa prej këtyre aktiviteteve.

Stafi i DKSH-së gjatë vitit ka realizuar vizita nëpër njësitë shëndetësore, si në QMF ashtu edhe në AMF duke parë gjendjen dhe nevojat aktuale të stafit dhe të objekteve përkatëse.

Sikurse është planifikuar DKSH përmes QKMF-së ka realizuar vizitat sistematike për nxënësit e shkollave të mesme të ulëta të Komunës së Prizrenit, përkatësisht për nxënësit e klasave 1, 5 dhe 9 të këtyre shkollave. Pas realizimit të këtyre vizitave është bërë punimi statistikor i të dhënave të dala nga këto vizita dhe është realizuar edhe punëtori për prezantimin e këtyre të dhënave.

Gjatë këtij viti, është pranuar një donacion me paisje mjekësore dhe jo mjekësore për QMF Reqanë dhe Lubinje e Epërme nga Ambasada Bullgarisë.

Përgjatë vitit zyrtarët nga DKSH kanë marrë pjesë në takime dhe aktivitete të ndryshme, siç janë: puntoria e organizuar për PZHK (Planin Zhvillimor Komunal); puntoria e organizuar nga Terre Des Homes për hartimin e planit të veprimit për fëmijët me situatë rruge; punëtorja e organizuar nga OSCE lidhur me udhëzuesin për qasje në dokumentet publike; tryeza e rumbullakët e organizuar nga OSCE lidhur me praktikën e subvencionimit të iniciativave të grave në komunat e rajonit të Prizrenit; takimi i organizuar nga Down Syndrome Kosova dega në Prizren mbi avokimin për ngritjen e kapaciteteve organizative të PAK, në zbatimin e strategjisë dhe planit të veprimit 2024-2027; takimi i organizuar nga Medica Gjakova ku zyrtar të DKSH kanë marrë pjesë në cilësinë e anëtarit të komitetit drejtues të programit “Përmirësimi i shërbimeve dhe kujdesit shëndetësor ndaj stresit dhe traumës për gra dhe vajza të mbijetuara të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës seksuale”; takimi me këshillin e pacientëve dhe AQH; takimi i Forumit koordinues të organizatave të shoqërisë civile dhe Komunës së Prizrenit lidhur me parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna në baza gjinore; takimi i Grupit Punues për planifikimin dhe zbatimin e projekteve për përfshirjen e PAK; punëtorja e organizuar nga Qendra për Barazi dhe Drejtësi; punëtorja me OSCE lidhur me buxhetimin gjinor në Komunën e Prizrenit si dhe puntoria e organizuar nga OSCE lidhur me hulumtimin e realizuar për të drejtat e PAK; takimi me përfaqësuesit nga Caritas Kosova dhe Shoqata Nëna Terezë për të diskutuar rreth formave të bashkëpunimit në projektin Cares; etj.

Gjatë këtij viti është nënshkruar memorandum bashkëpunimi me DPMS lidhur me mbikëqyrjen e projekteve ndërtimore të kësaj drejtorie nga ana e OM të kontraktuar nga DKSH.

Përgjithësisht, këto janë punët, shërbimet dhe aktivitetet e realizuara nga DKSH gjatë vitit 2025.

DKSH, Prizren

Janar 2026

